

FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Data: 14.07.2016

Për: Operatorin Ekonomik "SMO Union" sh.p.k.

Procedura e prokurimit tender i hapur me objekt: "Rikonstruksion Rruga B.Curri – Cërricë".

Përshkrim i shkurtër i kontratës: "Rikonstruksion Rruga "B.Curri – Cërricë".

Kohëzgjatja: Duke filluar nga data e lidhjes së kontratës, me përfundim brënda 6 muaj nga data e fillimit të punimeve.

Fondi limit: 54.480.212 (pesëdhjetë e katër milion e katërqind e tetëdhjetë mijë e dyqind e dymbëdhjetë) Lekë (pa tvsh).

Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: Datë 17.06.2016.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Ka patur.

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara pa tvsh:

NR	SHOQERIA	OFERTA PA TVSH
1	S.M.O.UNION	34,894,900
2	"SHENDELLI"	36,520,680
3	MELA.	36,667,370
4	VARAKU E	38,207,502
5	COMPANY RIVIERA 2008	39,498,855
6	VLLAZNIMI	39,656,353
7	NIKA	40,082,683
8	DENIS-05	41,708,430

9	B-93	42,138,000
10	KEVIN KONSTRUKSION	44,286,626
11	FLORIDA	45,088,192
12	PE - VLA - KU	45,537,390
13	S I R E T A 2F	45,555,555
14	ALKO-IMPEX General Construcion	49,400,220

Janë skualifikuar shoqëritë:

1. BO “Shëndëlli” sh.p.k. (47,58%) dhe “Jody” sh.p.k. (52.42%) për arsye se:

Shoqëria ”Jody” sh.p.k, nuk plotëson pikën 2.4.1 për kualifikim lidhur me punet e ngjashme, pasi:

Për të provuar realizimin e punëve të ngjashme ka paraqitur dokumentacion për realizimin e objekteve: “Rikonstruksion i rrugës së fermerëve, fshati Metoq, Sarandë”. Për këta objekte nuk ka paraqitur faturat tatimore në përputhje me kërkesën për kualifikim.

Shoqëria ”Jody” sh.p.k. nuk plotëson pikën 2.4.3 për kualifikim lidhur me kualifikimet e stafit, pasi: për ing. mekanik Kristofor Lapa mungon CV, ndërsa për ing. topograf Jorgo Papa mungon diploma dhe CV.

Shoqëria ”Jody” sh.p.k. nuk plotëson pikën 2.4.7 për kualifikim pasi nuk ka paraqitur deklaratën e kërkuar për mosangazhimin e mjeteve.

Shoqëria ”Shëndëlli” sh.p.k. nuk plotëson pikën 2.4.1 për kualifikim lidhur me punët e ngjashme, pasi:

Për të provuar realizimin e punëve të ngjashme ka paraqitur dokumentacion për realizimin e objekteve: “Ndërtimi i rrugës Vidhisht Luar” i cili është jashtë afatit tre vjeçar, “Mirëmbajtje rutinë Fier – Seman” me vlerë 12.824.140 Lekë (pa tvsh), “Rikonstruksioni i by pass Frashër” me vlerë 11.243.783 Lekë (pa tvsh) dhe “Rruga e fermerëve fshati Metoq Sarandë” me vlerë 37.677.235 Lekë (pa tvsh). Nga objektet e mësipërm objekti “Ndërtimi i rrugës Vidhisht Luar” është jashtë afatit tre vjeçar, objekti “Mirëmbajtje rutinë Fier – Seman” nuk mund të konsiderohet si objekt i ngjashëm pasi janë punime mirëmbajtje, ndërsa për objektin “Rruga e fermerëve fshati Metoq Sarandë” nuk janë paraqitur faturat tatimore. Objekti “Rikonstruksioni i by pass Frashër” me vlerë 11.243.783 Lekë (pa tvsh) nuk plotëson kërkesën pasi bazuar në përqindjen e punës që ka marrë përsipër kjo shoqëri puna e ngjashme me një objekt të vetëm duhet te kapte vlerën 12.960.842 Lekë (pa tvsh).

2. BO “Mela” shpk (42%), dhe “Alb Shpresa” sh.p.k. (58%) për arsye se:

Shoqëria ”Mela” sh.p.k. nuk plotëson pikën 2.3.4 të Kërkesave të Veçanta për Kualifikim lidhur me taksat vendore pasi nuk ka paraqitur vërtetime për likuidimin e detyrimeve për vitin 2016.

Shoqëria ”Mela” sh.p.k. nuk plotëson pikën 2.4.2 për kualifikim lidhur me numrin e punonjësve, pasi numri mesatar i punonjësve për periudhën e kërkuar është 16,2 punonjës ndërkohë që sipas përqindjes së punës që ka marrë përsipër mesatarja duhet të ishte jo më pak se 16,8.

Shoqëria "Mela" sh.p.k. nuk plotëson pikën 2.4.5 të Kërkesave të Veçanta për Kualifikim lidhur me liçencat pasi nuk disponon pikën NS-18 "Punime topogjeodezike" ndërkohë që për punët që ka marrë përsipër ky specialist është i domosdoshëm.

Shoqëria "Mela" sh.p.k. nuk plotëson pikën 2.4.8 të Kërkesave të Veçanta për Kualifikim lidhur me certifikatat ISO për arsye se nuk ka paraqitur dokumentacion.

Shoqëria "Alb Shpresa" sh.p.k. nuk plotëson pikën 2.1 gërma "dh" të Kërkesave të Veçanta për Kualifikim pasi nuk ka paraqitur deklaratën për disponueshmërinë e mjeteve sipas shtojcës 9.

Shoqëria "Alb Shpresa" sh.p.k. nuk plotëson pikën 2.3.4 të Kërkesave të Veçanta për Kualifikim lidhur me taksat vendore pasi nuk ka paraqitur vërtetime për likuidimin e detyrimeve për vitin 2016.

Shoqëria "Alb Shpresa" sh.p.k. nuk plotëson pikën 2.4.3 të Kërkesave të Veçanta për Kualifikim lidhur me stafin, pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar.

3. BO "Vllaznimi" sh.p.k. (80%) dhe "Griald" sh.p.k. (20%) për arsye se:

Shoqëria "Vllaznimi" sh.p.k. nuk plotëson pikën 2.4.1 për kualifikim lidhur me punët e ngjashme, pasi për punët e ngjashme të deklaruara nuk ka paraqitur faturat tatimore.

Shoqëria "Griald" sh.p.k. nuk plotëson pikën 2.3.4 të Kërkesave të Veçanta për Kualifikim lidhur me taksat vendore pasi nuk ka paraqitur vërtetim për likuidimin e detyrimeve në Tiranë, vend ku ushtron aktivitet referuar QKR.

Shoqëria "Griald" sh.p.k. nuk plotëson pikën 2.4.1 për kualifikim lidhur me punët e ngjashme, pasi për të provuar realizimin e punëve të ngjashme ka paraqitur dokumentacion për realizimin e objektit: "Ndërtimi i kabinës së re shtyllore 6 KVA, Vasil Shanto 2" me vlerë 3.975.252 Lekë (me tvsh). Bazuar në përqindjen e punës që ka marrë përsipër kjo shoqëri duhet të kishte paraqitur dokumentacion për realizimin e një pune të ngjashme me vlerë jo më pak se 5.448.021 Lekë (pa tvsh), pra objekti i deklaruar në tender jo vetëm nuk arrin vlerën minimale të kërkuar, por nuk mund të konsiderohet as si i ngjashëm me punimet që prokurohen.

4. BO "Nika" sh.p.k. (25,3%) dhe "Kthella" sh.p.k. (74,7%) për arsye se:

Shoqëria "Kthella" sh.p.k. nuk plotëson kërkesën 2.3.3 për kualifikim lidhur me disponimin e vlerave të mjaftueshme monetare për të realizuar objektin e tenderit pa marrë paradhënie, pasi sipas përqindjes së punëve që ka marrë përsipër në marrëveshjen e bashkëpunimit duhet të paraqiste dokumentacion për disponimin e një shume jo më të vogël se 4.069.672 Lekë, ndërkohë që disponon në total 2.846.986 Lekë dhe 905 Euro, pra rreth 2.955.586 Lekë, duke mos e plotësuar këtë kusht.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin Ekonomik "SMO Union" sh.p.k.**, se oferta e paraqitur, me vlerë **34.894.900 (tridhjetë e katër milion e tetëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e nëntëqind)** Lekë (pa TVSH) është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Autoritetit Kontraktor:**

- **Fondi Shqiptar i Zhvillimit**
- **Rr. "Sami Frashëri", Nr. 10, Tirana, Albania**
- **Phone: 00355 4 2 235 597/8 (int.151)**

- **Fax: 00355 4 2 234 885**

sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda pese ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në date: **06.07.2016**.

Ankesa nuk ka patur.

